




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Bazuar në nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr.03/L-087, në nenin 39 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.06.2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË
AKSIONARËVE NË PPP "ECOHIGJIENA" (PËR PJESËN PUBLIKE TË KRM
"HIGJIENA") NË GJILAN

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit emëron dy anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në PPP "Ecohigjiena" për pjesën publike të KRM "Higjiena", dhe atë:

1.1 Xhelal Jetishi

1.2 Muhadin Haziri

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve si në pikën I të këtij vendimi i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni po ashtu do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes "Ecohigjiena" në interes të Komunës.
3. Komisioni, për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçantë
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesja e KK-së.
5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-72577
Gjilan, më 27.06.2014

Kryesuesja e Kuvendit
Valentina Bunjaku-Rexhepi